

# *Identiteti personal dhe masskultura*

*Ibrahim Berisha\**

## **Përmbledhje**

Identitetet personale edhe në Kosovë krijohen përmes ndikimit të përmbajtjeve të massmedies. Sistemet e madha dhe të shumëllojshme teknologjike-komunikuese kanë lehtësuar konvergjimin e marrëdhënieve personale dhe kolektive në kontekste shoqërore dhe kulturor. Po kështu, identiteti personal është joshur nga faktorë që e orientojnë konstruimin e tij kah virtualja. Identiteti i përmirësuar, i retushuar dhe artificial, që krijohet në një hapësirë të tillë virtuale përmes massmedies e pasuron dhe lojën e roleve kulturore që nuk janë të përputhshme me rolet në jetën reale. Rolet nuk japin, por marrin nga publiku energjinë e pasistemuar kulturore dhe ia dhurojnë atë pushtetit të përfaqësueseve kryesisht korporativ, të cilët menaxhojnë me përfitimin e publike.

**Fjalët kyçe:** *Identitet personal, massmedia, masskulturë, multikulturalizëm, virtual, rol, e drejta publike.*

## ***Identiteti, industria e kulturës***

Masskultura ka përmytur konceptin konvencional të identitetit personal, i parë ngushtë, nga korniza tradicionale, duke e lidhur atë kryesisht me vlera dhe ambiente autentike, burimore, lokale, qoftë gjeografike qoftë sociale. Konsumi i vlerave globale dhe hapësira globale e komunikimit, ndryshoi agjensët ndikues kryesorë në krijimin e opinioneve po edhe të identitetit personal dhe kolektiv. Media ndryshoi konceptimin e jetës. Imazhet e artistëve të serialeve që mbushin programet e televizioneve lokale dhe nacionale janë të njohura njësoj në gjithë kontinentet. Personazhet e këtyre serive që i shohim në TV, jetojnë jetën të cilën do të dëshironim ta bënim të gjithë – dhe për këtë nuk mundohen shumë.<sup>1</sup> Nuk janë frymëzues më as për

---

\* Prof. asoc. Dr. Ibrahim Berisha, Universiteti "Hasan Prishtina", Universiteti AAB – Prishtinë. E-mail: iberisha5@hotmail.com

<sup>1</sup> Niel Postman, *Amusing ourselves to death*, Penguin, USA, 1985, f. 154.

fëmijët personazhet e librave, por ato të masmediave. Fëmijët leximin e kanë zëvendësuar jo pak me konsumin e përmbajtjeve mediale.<sup>2</sup> Komunikimi ndryshoi në formë dhe tematikë duke përfshirë gjithë moshat dhe kontinentet.

Lidhjet emotive jo vetëm me të afërmit, të njohurit, miqtë, por edhe me natyrën, ambientin dhe prodhimet e tij, sa më shumë që u zhvilluan komunikimet digjitale, aq më shumë u zbehen dhe u rralluan. Pikërisht studiues të traditës, ndër të cilët edhe Raymond Aron, gjykojnë se një nga arsyt kryesore të “origjinës së diferencimit shoqëror është dezintegrimi i solidaritetit mekanik dhe i strukturave segmentare”. Në këtë mënyrë shpejtohet procesi i humbjes së këtyre lidhjeve.

Media ndikoi të zbehet edhe autoriteti, përkatësisht nënshtrimi grupit në të cilin në krye do të jetë “bajraktari”, “kryeplaku” “kryefamiljari”, “mësuesi”, “bosi”. Është liria më e theksuar personale që stimulohet dhe frymëzohet nga mediet, pasi ato bëjnë që të ndryshojë edhe llogaridhënia, nga ajo morale në favor llogaridhënies ligjore, nga llogaridhënia kolektive, në llogaridhënien personale.

Pra kemi të bëjmë me ikjen e autoritetit tradicional, duke pajtuar përgjegjësinë me detyrimin ndaj jetës publike. Në këtë rast, solidariteti mekanik i njohur si një tirani unike dhe krenare, i cili ishte shumë i

---

<sup>2</sup> Më shumë se 30 për qind e fëmijëve kurrë nuk lexojnë në kohën e lirë. Hulumtimet, të cilat i ka kryer Fondacioni nacional për shkrim dhe lexim nga Britania e Madhe, ka përfshirë më shumë se 21.000 fëmijë.

Kur ka filluar hulumtimi në vitin 2005, katër nga dhjetë fëmijë kanë konfirmuar që lexojnë në kohën e lirë dhe që leximi është pjesë e rutinës së tyre ditore, raporton koha.net. Kjo shifër sot ka rënë në rreth tre nga dhjetë fëmijë. Numri i fëmijëve të cilët lexojnë stripa dhe revista po ashtu ka rënë nga 75 për qind në 57 për qind. Siç thonë ekspertët, fëmijët më nuk lexojnë nga argëtimi sepse kohën e tyre gjithnjë e më shumë e përmbushin obligimet e shkollës. Hulumtuesit po ashtu kanë zbuluar që fëmijët më me qejf zgjedhin të shikojnë programin e tyre të preferuar televiziv se sa të lexojnë. (Mbi 30 % e fëmijëve nuk lexojnë në kohën e lirë- koha ditore, portali, <http://koha.net/> 2014-08-31 23:40:17 )

fuqishëm në Kosovë edhe për arsye se pjesa më e madhe e popullsisë jetonin në bashkësi më të mëdha familjare dhe në hapësira rurale, lëndohet pak nga pak, duke u dominuar nga solidariteti organik, pikërisht përmes shtimit të përgjegjësisë publike, përmes individit të përgjegjshëm dhe komunikimit të papenguar publik, edhe në medie, natyrisht. Nëse do të jetonte individi në një ambient social ku është më fuqishëm i shprehur solidariteti mekanik, atëherë përgjegjësia për të gjitha që ndodhin, edhe për personin, është e deleguar tek grupi dhe, llogaria përfundon tek hierarkia e grupit. Ndryshe, pra nga ky nivel i njohur, që është trajtuar gjerësisht nga Emil Dyrkemi, tek solidariteti organik autoriteti nuk delegohet tek grupi, përkatësisht "bajraktari", "kryeplaku" "kryefamiljari", "mësuesi", "kleriku", "bosi", por mbahet dhe komunikohet si përgjegjësi individuale. Në këtë rast, edhe pluralizmi medial ndikon në krijimin e identiteteve plurale.<sup>3</sup>

Identiteti personal është i joshur nga faktorë që e orientojnë konstruimin e tij kah virtualja, e cili është më shumë projekt dhe misitizëm se sa formë dhe përmbajtje konkrete. Po njëherësh, thyerja e hapësirave të kufizuara konvergjojnë shumë ndikues në krijimin e gjykimit për këtë model personaliteti. Njeriu veprimet edhe më personale, më intime, i ndanë me një botë të etshme për të parë dhe dëgjuar të jashtëzakonshmen dhe të paimagjinueshmen, gjithsesi të panjohurën dhe të dëshiruarën. Ky njeri që ka shumë minipersonalitet, ndikohet nga komunikimet publike, sepse vetëm duke ndryshuar shumëfish rolet apo edhe mini-rolet, njeriu mbetet një lojtar që tërheq interesin e të tjerëve, ndërsa ata që e duan hapësirën publike, këtë lojë e menaxhojnë me përpikëri për të mbajtur në suaza të opinioneve apo bashkësive të përbashkëta edhe kulturore edhe sociale. Do referuar qasjes antropologjike të Erving Goffmanit<sup>4</sup> për

---

<sup>3</sup> Brian McNair, *Striptiz kultura*, Zagreb, 2004, f., 20.

<sup>4</sup> Goffman ishte micro-sociolog dhe antropolog, ndër tjera krijoi termin "institucion total", një ndër ekzaminimet e para sociologjike për gjendjen e pacientëve mendor në spitalet psikiatrike dhe të kuptuarit e aspekteve sociale të të sëmurëve mental (shih. Weinstein R. (1982). "Goffman's Asylums and the Social Situation of Mental Patients". *Orthomolecular psychiatry* 11 (N 4): 267-274).

rolet që luajnë njerëzit. Ai thoshte se njerëzit performojnë role në situata të ndryshme shoqërore, me sjelljet e tyre tërheqin vërejtjen dhe kureshtjen e të tjerëve, tregojnë ego-identitetin e tyre si proces interaktiv dhe dinamik, d.m.th se udhëtojnë duke kërkuar të gjejnë për veten e tyre dhe “të tjerët”tribute të reja që nuk i kanë pasur dhe as nuk i kanë. Shumë nga këta njerëz që i kërkojnë këtotribute të munguara as që do t’i gjejnë ndonjëherë, por e mira e tyre është se ata nuk ndalen së kërkuari dhe këmbëngulin duke pasur shije e kënaqësi për “vetëmashtrimin përjashtues”. Ata mjaftohen nëse mbërrijnë t’u pranohen përpjekjet dhe munda i tyre nga autoriteti.

Për ta mbështetur këtë gjykim do t’i referohemi edhe Sherry Turkle që kishte shënuar në kontekstin e konsumit të përmbajtjeve mediale se kur secili lojtar mund të krijojë shumë karaktere dhe të participojë në shumë lojëra, vetja nuk është vetëm e decentralizuar, por e shumëfishuar pa kufi.”<sup>5</sup> Pra, është hapësira e pa kufi, dhe mundësia për të luajtur në këtë hapësirë me shumë karaktere, me shumë role, me shumë dimensione, të cilat janë përcaktuese të krijimit të marrëdhënies edhe në komunikimet interpersonale edhe ato grupe dhe së fundi, në komunikime mediale, globale. E rëndësishme është se këto marrëdhënie funksionojnë për të mbajtur ndikimin e rolit personal në kohë dhe hapësirë, dhe gjatë këtij procesi dinamik nuk është aq e rëndësishme nëse do të përkufizohen ato si konkrete apo virtuale.

Mediet sociale janë agjensi më i shtrirë tani që i shërben edhe riformatizimit të identitetit personal, mbasi duke luajtur rolet në një fushë jo formale, të mjegullt, me mundësinë edhe të paraqitjes së vetvetes ashtu si dëshiron të jetë dhe jo ashtu siç është, individi fillon të ndryshojë nga brenda emocionalisht dhe po kështu gjykon se këtë ndryshim e përcjell edhe te bashkë komunikuesit, numër të madh të të cilëve as nuk i njeh dhe as nuk do t’i njoh ndonjëherë. Sociologu spanjoll Manuel Castellas në një kontekst më të gjerë, duke folur për rrjetet sociale potencon përkufizimin e identitetit primar, i parë ky si identiteti që i formëson edhe identitet tjera, dhe është edhe i

---

<sup>5</sup> Sherry Turkle “Life on screen; Identity on the age of internet”, Tauchstone, New Yourk,1997, fq. 185.

vetëqëndrueshëm në kohë dhe hapësirë. Personalitetet e masskulturës<sup>6</sup> pikërisht potencialin e tyre të pranuar si identitet kulturor global, e kanë të lidhur ngusht me pranimin nga të tjerët, si një identitet më shumë virtual se sa real, pra më qëndrueshmëri fluide në kohë dhe hapësirë. Kjo ndërlidhet edhe me masskulturën, e cila ka jo pak ka frymë virtuale. Në fund të fundit, njerëzit, gjithmonë kanë jetuar në shoqëri të cilat gjatë historisë së tyre, ishin multikulturore.<sup>7</sup> Po nëse kërkojmë një përkufizim më preciz të multikulturalizmit, atë do gjetur në literaturën kanadeze, prej nga edhe ka burimin. Për herë të parë ky term ndeshet pikërisht në këtë vend, i cili kishte më shumë kultura, madje edhe gjuhësore, si më të shprehura ajo angleze dhe franceze. “Multikulturalizmi”, do të thotë, ndër të tjera, bashkëjetesa brenda një shoqërie të njëjtë politike, të një numri mjaft të madh të grupeve kulturore, të cilat dëshirojnë dhe në parim, janë të në gjendje, të ruajnë identitetin e tyre të veçantë.<sup>8</sup> Mashtrimi paraqitet kur një përdorues aktiv i facebook apo po edhe rrjeteve tjera sociale, nga komunikimi simbolik, mendon se është tashmë një njeri shumë i popullarizuar, i respektuar, me profil të veçantë që i hap rrugën për veprime reale. Gjykimi nga marrëdhënie virtuale ka të bëjë me aksione reale, që nuk përkojnë me forcën dhe profilin që e disponon një përdorues interneti. Një formë e këtij komunikimi të diskutueshëm janë edhe shkrimet që mund të mos jenë të autorit në adresën elektronike. Më së miri këtë e dëshmojnë kandidatët politikë për poste që duke aktivizuar dhe punësuar ekipe shkruesish të panjohur për komunikuesit, nënshkruhen me emër konkret të tyre, edhe pse nuk kanë të bëjnë me prodhimin e vet, sa do që adresohet kjo si komunikim personal. Krijimi i vetërespektit nga këto paragjykime nuk është i barasnumëruar me gjykimin e “miqve” komunikues. Humbja e miqve konkretë dhe fitimi i miqve virtual e vulos procesin e

---

<sup>6</sup> Masskultura përcakton gjerësinë, totalitetin, universalizmin, pakufishmërinë, elementë këta që janë cilësi të globalizmit. Masskultura mediale është e ndikuar nga tregu global, sepse tashmë korporatat multinacionale prodhojnë dhe transmetojnë përmbajtje jo vetëm një hapësirë të caktuar, por për gjithë njerëzimin.

<sup>7</sup> Joseph Raz, *Multiculturalism*, *Ratio Juris*, VOL. 11, nr.3 sep. 1998. f. 194

<sup>8</sup> Po aty. f. 197

të jetuarit të vetmisë fizike duke ndikuar edhe në identitetin personal. Shoqëri e vetmisë, apo shoqëri me vetminë, mund të përkufizohet nocioni i joshqërimnit, ndikuar nga përdorimi i gjatë i internetit, qoftë edhe nëse bëhet fjalë për komunikim interpersonal. Nuk ka ndonjë dilemë se çfarë dallon komunikimi fizik nga komunikimi teknologjik. Shmangia nga interaktiviteti fizik, social, e shton vetminë, mbasi pavarësisht se marrëdhënia komunikuese teknologjike duket plotësisht sociale ajo humb në plotësinë, sepse nuk dhuron gjithë vlerat dhe dinamikën psiko-sociale, të tillë që ofron komunikimi fizik, sy me sy, ballë për ballë. Ky komunikim vetëm sa e shton kohën e kaluar vetëm.<sup>9</sup>

Identiteti i përmirësuar, i retushuar dhe artificial, që krijohet në një hapësirë të tillë virtuale, është i rëndësishëm mbasi e bën të mundur lojën e roleve, në të cilën pranohet statusi të mos jemi ata që jemi, por të jemi ashtu si dëshirojnë të na shohin dhe si dëshirojmë t'i shohim ne ata. Është fjala për një konstruim virtual dëshirash, projekt për të qenë sa më të "pranuar nga të tjerët". Duam të na shohin si "vetja jonë më e mirë."<sup>10</sup> Siç është shënuar nga sociologë dhe antropologë, fotografitë, mesazhet, email-at e postimet e ndryshme, "na lejojnë të prezantojmë vetën ashtu siç duam të jemi."

Njeriu jeton në dy botë, nëse nuk ka identitet në botën reale, këtë mungesë, me gjasë do ta kompensojë me botën virtuale. Demokratizimi i dëshirave dhe emocioneve, me internetin merr përmasën e pakufishme. Arti dhe kultura e popullarizuar (jo popullore) lidhen me modernizmin dhe postmodernizmin. Në qendër të shumë ngjarjeve mediale filmike paraqitet "vajza e keqe", pornografizimi i kulturës. A lidhet kjo me emancipimin e femrës; sa më shumë që emancipohet femra aq më shumë ajo pjesë e striptiz kulturës.<sup>11</sup> Gjeografia po edhe përmbajtja e komunikimeve krijoi nocionin teknologjik, hapësirë shoqërore koherente, studiuar edhe nga Gustavo S. Mesch . Është pikërisht qëllimi dhe interesi i njëjtë,

---

<sup>9</sup> Barry Wellman and Caroline Haythornthwaite, *The Internet in everyday life*, Blackwell Publishers Ltd, UK, 2002, fq. 227.

<sup>10</sup> Sherry Turkle, *Alone Together; Why We Expect More from Technology And Less from Each Other*, New York, 2011, f.160.

<sup>11</sup> Brian McNair, *Striptiz kultura*, Zagreb, 2004, f. 20.

koherent, të shumtën që bashkon subjektet komunikuese. Temat e komunikimit dhe interesimet psiko-fizike dhe po kështu sociale e kulturore i bëjnë këto lidhje përkatësi të “përbashkët” po me synime divergjente. Anonimitetet impulojnë konvertimet e personaliteteve, ky një mundësi eksperimentuese<sup>12</sup> ndërmjet vetes dhe atyre që hyjnë në bashkësinë “miqësore”.<sup>13</sup>

Jeta virtuale kryesisht konstruohet për të qenë i i padukshëm në dukshmërinë e vetëprojektuar, një pamje konstrukt për të tjerët, për ata që nuk njohin të kaluarën tënde, dhe natyrisht marrëdhënia nis nga e sotmja, pa pasur edhe detyrimin që ajo të ndërtohet mbi fakte dhe realitete konkrete. Studiuesja Sherry Turkle duke rezimuar efektet e teknologjive komunikuese në këtë aspekt, veçmas në kontekst të internetit, ngrit dilemën po dhe shqetësimin, nëse do të mund njeriu të sundojë kahen nga e drejton rrugën kjo teknologji. Teknologjia po na drejton në vende, në të cilat ne nuk dëshirojmë të shkojmë. Edhe masskultura është pjesë e këtij sistemi të udhëtimit, dhe jo rrallë pikërisht kjo veprimtari, vërteton dilemën dhe shqetësimin e kësaj studiueseje.

Edhe nisja e artistëve që duan të bëhen pjesë e sferës masive kulturore, nuk është e qartë, por rruga që ndjekin ata, po kështu i dërgon madje edhe atje ku nuk kanë pasur synim apo edhe nuk kanë ëndërruar të mbërrijnë. Një artist lokal apo nacional, deri në mesin e shek. XX e kishte vështirë të shihej nga të tjerët, në mënyrën që ai dëshironte. Ai duhej të bënte hapa konvencionalë, të ikte, fjala vjen në Holivud, për t’u provuar nëse ka ndonjë shans të bëhej pjesë e sistemit të madh filmik. Ai kërkohej të bënte veprime fizike, të dukej atje ku kishte shpresë se e kërkonin dhe e dëshironin që të ishte në kontaktin artistik me publikun. Kjo ndodhte edhe me një shkrimtar, një piktorë, apo një kompozitor a këngëtar. Teknologjia komunikuese, komunikimi medial e ka thyer këtë lëngesë konvencionale, dhe lëvizja e marrëdhëniet kryesore, tani realizohen përmes rrjeteve të internetit, duke e lehtësuar shumëfish, nisjen në një rrugë, që natyrisht, nuk është asnjëherë e sigurt se çfarë do të jetë.

---

<sup>12</sup> Po aty, fq. 54.

<sup>13</sup> Po aty.

Aspirata e lidhjes së njerëzve, komunikimi dhe këmbimi i mendimeve dhe ideve, pamjeve dhe figurave, dëshirave dhe ëndrrave, që bëhet ndër shekuj vetëm duke komunikuar verbalisht, pastaj me shkrim, tashti ka fituar përmasën e pakufizueshme. Lidhjet ndërmjet njerëzve që nuk njihen, projektojnë marrëdhënie ideale. Madje, të çfarë do qoftë ato, e kanë ndryshuar edhe vetë qenien njerëzore, duke e bërë më të brishtë dhe më ilegale se sa ka qenë ndonjëherë në historinë e tij. Fshehtësia është ajo që bëhet publike, por mbetet ende e tillë, sepse gjithmonë ruan diçka të pathënë, jo rrallë thelbësore, ndërsa në anën tjetër, thotë, glorifikon dhe dramatizon gjëra dhe fakte që nuk janë të tilla, mbase ndonjëherë nuk ekzistojnë fare në realitet. Ky është një identitet i ri personal, që është i ngjashëm në të gjitha anët e globit, duke pasur të njëjtin stimulues dhe furnizues, mediet dhe veçmas, rrjetet sociale.

Teknologjitë komunikuese kanë ndërthurë hapësirat e vogla dhe të mëdha, kanë barazuar njerëzit e pasur dhe të varfër dhe njëherësh edhe kanë bërë të mundur udhëtimin komunikues të gjithë atyre që këtë e dëshirojnë. Njerëzit dëshirojnë të jenë me njëri-tjetrin, mirëpo edhe të jenë të lidhur me të tjerët nëpër vende të ndryshme. Dhe është kjo pikërisht marrëdhënia edhe masskulturore që krijohet në hapësirën virtuale duke u dërguar mesazhet nga hapësirat lokale.

Frika nga kjo ofertë shumë e pasur teknologjike lehtësisht vihet në pikëpyetje duke humbur arsyen, në cilën botë komunikimi gjendet komunikuesi i parë dhe ai i dytë. Ai që jep dhe ai që merr, gjithnjë duke i ndërruar rolet. Ky akomodim emocional që ofron teknologjia mund të ndikojë në tensionimet shpirtërore dhe psikologjike, bën vartës të pritjes dhe shpresës, të asaj që nuk dihet se ku është dhe nëse do të vijë ndonjëherë ndonjë gjë që nuk është e qartë plotësisht për çfarë është fjala. Komunikimi i tillë, për shumë njerëz, është një sinonim i dramës së Beketit "Duke pritur Godonë", një protagonist që mbase edhe mund të vijë, kur pritësi më nuk është fare i gjallë. Që dmth se nuk ka një linjë normale pritjeje kulturore dhe as sociale për kategoritë e ndryshme që hyjnë në marrëdhënie komunikimi pa pasur një agjendë të qartë apo edhe kur hyjnë, këtë e bëjnë me një agjendë që nuk e kanë shumë të njohur dhe nuk e mendojnë se ku do t'i qesë në fund. Edhe në këtë rast, kemi të bëjmë me humbjen e disa vlerave

identitare personale, dhe mbetja pa to nuk nënkupton zëvendësimin me tjera, mbase edhe më të mira, por të shumtën e herëve, komunikuesit e tillë, mbesin në një botë të humbur, të paqenë, dhe nuk mund të orientohen se ku është e vërteta dhe ku e pavërteta. Ata që kuptojnë dhe dinë të orientohen në këto komunikime, tregojnë një standard dhe përgatitje konkurruese për të marrë pjesë në marrëdhënie jo vetëm interpersonale, publike, por edhe mediale. Po njerëzit racionalë ruajnë identitetin e tyre personal, shmangin mundësinë e pakontrolluar të shpenzimit të kohës dhe energjisë së tyre fizike dhe mendore. Kjo bëhet normë, edhe pse disa janë në gjendje më të mirë, sepse ndihen të kenë situatën nën kontroll, madje komunikimi në internet gjithashtu ofron një mundësi për të injoruar ndjenjat e njerëzve të tjerë".<sup>14</sup>

Komunikimi i shumëfishuar që e mundëson teknologjia ndikon edhe në shtimin e alternativave të konflikteve brenda personalitetit, posaqërisht të konsumuesit që nuk është i përgatitur për të seleksionuar sasinë dhe cilësinë e tyre. Kjo, natyrisht që i shton burimet e krizës jo vetëm të individit, por edhe të grupit, bashkësisë. Rastet me Pranverën Arabe (2012) kur ranë regjime autoritare (Tunizi, Libi, Egjipt) po edhe rasti i Bosnjës (2013) kur të rinjtë u mobilizuan përmes teknologjive komunikuese në rrjetet sociale, për të protestuar dhe artikuluar kërkesat sociale, tregon se kriza tashti nuk mund të përjashtojë një indikator të qenësishëm, dhe ky është interneti, rrjetet sociale në te.

Një nga problemet që paraqiten në këtë marrëdhënie rolesh publike, dhe po kështu edhe kulturore, është edhe bashkimi i individëve të një grupi pa pasur shumë të qartë se cilat janë vlerat që e shquajnë atë grup dhe nëse ai fare ka vlera të ngjashme sa ta bëjnë të njëjtë me anëtarët tjerët të grupit. Jo rrallë, shkëputja vjen pikërisht si kuptim i së vërtetës, e cila e lehtëson ndarjen ndërmjet individit dhe grupit. Betty Friedan<sup>15</sup> njih edhe dallueshmërinë në përkatësinë e

---

<sup>14</sup> Alone Together; *Why We Expect More from Technology And Less from Each Other*, Sherry Turkle, Basic Books, New York, 2011, f. 177.

<sup>15</sup>Betty Friedan, në vitet '60 te shek. XX, lidere e Lëvizjes së Grave në SHBA, themeloi dhe u zgjodh presidentja e parë e Organizatës Kombëtare për Gratë, e cila synoi gratë t'i vë "në rrjedhat e shoqërisë amerikane në

njëjtë, e cila mundëson mbijetesën e grupit edhe kur anëtarët nuk janë të farë standardi njohjesh, dijesh dhe sjelljesh të njëjta, që bëjnë të ketë edhe veprime po kështu të njëjta.

Komunikimet mediale kulturore edhe mund të shtojnë krizën e identitetit, sa do që mundësojnë shprehjen e tij në mënyrë të lehtë dhe të gjerë. Po, kriza e identitetit personal, bartet dhe ndikon në krizën e bashkësisë. Kriza e bashkësisë stimulon më shumë ideologjizimet dhe variantet e konflikteve, marrëdhënieve të shumëfishta sociale dhe kulturore. Këto marrëdhënie ushqehen me “të drejtën publike”, për të zotëruar autoritetin e mediatizimit mbi objektin dhe subjektin social dhe fizik. Teoritë kulturore madje nuk kanë arritur të japin ende një përgjigje të plotëpranueshme pse ndodh ndryshimi i roleve kaq papritur, të cilat nuk pushojnë, por përherë janë në një proces rigrupimi edhe kur shoqëria bëhet se ka kapërcyer pragun formal, i njohur ky si një mozaik i qetësisë dhe ikonografizimit mediatiko-kulturor. Një nga shpjegimet duhet kërkuar në ndryshimet e përhershme që ndodhin në identitetin personal. Modelet kulturore ndryshojnë dhe mbulojnë njëra tjetrën.

Publiku kulturor sado homogjen të jetë, sado që e manifeston përmes simbolikës dhe shenjave këtë një përkatësi, nuk është asnjëherë aq i pajtueshëm sa paraqitet në marrëdhënie me të tjerat grupe. Përherë identiteti, pra egoja personale, do të jetë e fshehur, e ruajtur me përkujdesje, edhe pse manifestimet e kësaj egoje nuk duken të jenë asnjëherë të pranishme në individin që i përket një identiteti aktiv kolektiv.

Kur përmendet “e drejta publike” ka këtu pikërisht një keqkuptim të akomoduar me pajtimin heshtur të përfaqësuesve, që identifikohen po aq edhe arsyetohen, më pozitën e rastit që u është dhënë nga të tjerët në mirëbesim, dhe kjo shprehet që ata të jenë në fokus të sakrificimit të personales kulturore për interesin kulturor të përgjithshëm. Masskulturalistët përfitojnë nga kjo marrëdhënie. Ngjarjet e stisura, më mirë thanë të shpifura, dukja e tyre, deklaratat, intervistat dhe pamjet e dekoruara fizike e imponojnë ofertën pa

---

partneritetit plotësisht të barabartë me burrat”. Idetë për partneritetin e grave me burrat e konceptoi në librin “The Feminine Mystique” (1963)

kërkesë. Artificialiteti imponimohet pa respektuar realen dhe racionalen kulturore. Emocioni provokohet përmes pamjes që është tani më shumë dizajn sesa fiziologjikum.

### ***Përfundim***

Rolet nuk japin, por marrin nga publiku energjinë e pasistemuar kulturore dhe ia dhurojnë atë pushtetit të përfaqësueseve kryesisht kooperativ, të cilët menaxhojnë me përfitimin e publikes. Rolet ndryshojnë sepse identitet personale kulturore ndryshojnë. Në këtë mënyrë individi ruan komponentet e vlerave personale duke manifestuar publikisht njëtrajtësi dhe johomogjenitet me grupin, kolektivin. Ndryshe, po të ishte plotësisht i pajtuar identiteti personal me atë kolektiv, nuk do të kishte ndryshime dhe lëvizje individësh nga një grup kolektiv te tjetri, duke provuar të dëshmojnë se burim i kësaj lëvizjeve është pikërisht pamundësia për të manifestuar vlera dhe potenciale të identitetit personal. Mospërputhja e dëshirave, mundësive personale me ato kolektive, përfundon në abstenim publik mbasi një shkëputje nga përkatësia dhe vetëdija kolektive, domosdoshëm do të ketë nëse jo reagime, atëherë shmangie nga vëmendja e grupit.

### ***Bibliografia***

Postman, Niel. *Amusing ourselves to death, Penguin*. USA, 1985.

McNair, Brian . *Striptiz kultura*. Zagreb, 2004.

Weinstein Raymond. "Goffman's Asylums and the Social Situation of Mental Patients". *Orthomolecular psychiatry* 11. N 4, 1982. (267-274).

Turkle, Sherry. *Life on screen; Identity on the age of internet*, Tauchstone. New Yourk:1997.

Raz, Joseph. *Multiculturalism, Ratio Juris*, VOL. 11, nr.3 sep. 1998.

Wellman, Barry & Haythornthäite, Caroline. *The Internet in everyday life*. Blackwell Publishers Ltd, UK, 2002.

*Ibrahim Berisha*

Turkle, Sherry. *Alone Together: Why We Expect More from Technology And Less from Each Other*. New York. 2011.